



In medias res

Planifikimi, Thembër e Akilit e ndryshimeve në arsimin e Kosovës (2)

Një ndër shkaqet kryesore të dështimit të ndryshimeve në sistemin e arsimit të Kosovës ka qenë dhe është qasja reaktive. Kjo do të thotë se në fushën e arsimit kemi reaguar ndaj ngjarjeve dhe dukurive të imponuara, problemeve dhe të vështirësive të paraqitura. Pra gjithnjë jemi marr me pasojat, e jo me shkaqet. Kështu në vend se ne t'i identifikojmë prioritetet dhe nevojat themelore në vitin 1999 dhe mbi bazën e këtyre prioriteteve të artikulojmë të ardhmen tanë të dëshiruar në fushën e arsimit. Duke krijuar ngjarje të reja, ne jemi marrë me zgjidhjen e problemit që me të vërtetë kanë qenë më akute. Kështu, për shkak të djegies dhe të rrënimit të qëllimshëm të objekteve shkollore nga ushtria dhe forcat të forcave serbe (janë djegur me shumë se 1050 objekte shkollore ose mbi 60% të gjitha objekteve që kanë ekzistuar para vitit 1987), ne në kohe tërë energjinë dhe resurset i kemi orientuar në ndërtimin e objekteve shkollore (shih foton).



Natyrisht se kjo ka qenë e domosdoshme, por një orientim i këtillë ka qenë një qasje reaktive, marrje me pasojat, e jo edhe me shkaqet.

Që në atë kohë është dashur t'i identifikojnë problemet më të mëdha dhe nevojat prioritare të arsimit. Ndër këto nevoja që është dashur të merremi ka qenë krijimi i një projekcioni zhvillimor të arsimit për periudhën 1999-2005. Me këtë projekcion zhvillimor, ne do të krijojmë ngjarje të reja të cilat do të përshpejtonin daljen e sistemit

të arsimit nga kriza. Në këtë aspekt do të formoheshin grupet e eksperteve që do të hartonin planin e rrjetit të shkollave fillore dhe të mesme, planin për tejkalimin ndasive etnike dhe krijimin modeleve për të një sistem sipas masës së njeriut, me çka do të do preventohej dezintegrimi i sistemit të arsimit në dy sisteme të bazuara në konflikte të identiteti etnik, pasojat e ndarjes së cilës po përjetohen rëndë edhe sot nga qytetarët e Kosovës, do të krijohej mekanizma të fuqishëm për garantimin e cilësisë në arsim, do të përgatiteshin me kohë standardet e pedagogjike dhe paketa e treguesve sasior dhe cilësor të procesit dhe të rezultateve të punës edukative dhe arsimore në sistemin e arsimit etj, do të pamundësohej voluntarizmi dhe arbitraretet i administrative dhe autoritar i përfaqësuesve të UNMIK-ut, do të planifikohej një partneritet në kuptimin bashkëpunimit me ndërkombëtarë në parimin bashkëpunimit për interesa të përbashkëta.

Qasja proaktive nuk është asgjë tjetër pos krijimi i ngjarjeve të reja, apo artikulum i një të ardhme çfarë e kanë dashur qytetarët e Kosovës pavarësisht nga prejardhja tyre do ishte një emërues i përbashkët i krijimit të një shoqërie kohezive, miqësore për të gjithë dhe me njeriun në qendër. Ky artikulum i një të ardhshme të dëshiruar dhe të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës nuk është asgjë tjetër pos planifikim filantropik që mundëson zhvillimin maksimal të gjithë qytetarëve deri te kufijtë e tyre të skajshëm, andaj konstatimi i ynë se planifikimi ka qenë dhe ende është Thembër e Akilit është katërçipërisht i saktë.

Shkroi: Halim Hyseni

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

- Në kuadër të MKLSH-së me 10-11 prill është mbajtur seminari i IV për 4 grupet e mësimdhënësve që janë duke u trajnuar. Seminari është mbajtur në 4 qendra: Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Pejë.

Monitorimi i menaxhimit të financave komunale të arsimit në 5 komuna të Kosovës

- Në kuadër të projektit për Monitorim të strukturave komunale të Arsimit, gjatë prillit janë përfunduar intervistat me përfaqësues të DKA, auditor të brendshëm komunal, drejtore të shkollave, kryetar të këshillave të shkollave në 5 qendra të Kosovës: Prishtinë, Gjilan, Istog, Gjakovë dhe Vushtri.

Hap pas Hapi

- Me datat 24 – 26 prill në Gjakovë u mbajt Trajnimi Avancues për Klasën e dytë. Në këtë trajnim morën pjesë 27 pjesëmarrës. Pjesëmarrësit nga ky grup duhet që deri me 15 maj të përgatisin planifikimet e tyre. Pas prezantimit të këtyre planifikimeve pastaj do të bëhet certifikimi i tyre.

KOSOVISION Contest

- Gjatë këtij muaji janë implementuar shumica e projekteve shkollore ndërsa të tjerat pritet të përfundojnë deri në fund të muajit maj.

Përfaqësues nga Zvicra e po ashtu edhe stafi përgjegjës i këtij projekti janë vazhdimisht në vizita duke dhënë udhëzime të vazhdueshme rreth punës në projekte shkollore.



- Po ashtu në kuadër të këtij projekti kanë filluar edhe përgatitjet e para për organizimin e Ceremonisë finale ku do të bëhet edhe ndarja e shpërblimeve për fazën e dytë të projektit.



- Vlerësimi i projekteve do të bëhet në fund të muajit maj ku mësimdhënësit duhet ta dokumentojnë punën e tyre të bërë me nxënës.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

■ Në kuadër të këtij projekti “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e edukimit”, financuar nga Komisioni Evropian, janë organizuar aktivitetet sipas projektit. Gjatë muajit prill është mbajtur edhe trajnimi me grupin e gjashtë, respektivisht grupi i nxënësve boshnjakë. Po ashtu janë përgatitur edhe certifikatat e pjesëmarrjes në trajnim të cilat do të shpërndahen tek pjesëmarrësit në muajin maj.



Monitoruesit e jashtëm kanë bërë edhe monitorimin e dytë të drejtave të fëmijës në shkollat kontroll dhe të synuara dhe kanë vënë të dhënat e monitorimit. Tani mbetet që të bëhet analiza e tyre dhe të diskutohet ky raport i monitorimit.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

■ Të gjitha shtetet pjesëmarrëse në projekt i kanë përfunduar raportet nga “Hulumtimet Kombëtare” në kuadër të

komponentës 2 të Projektit. Ekipi i ekspertëve është duke punuar në hartimin e një sinteze të këtyre raporteve.

■ Sa i përket komponentës 3 të projektit “Praktikat më të mira” të gjitha ekipet kombëtare i kanë zgjedhur nga 3 praktika më të mira në vendin e tyre dhe janë duke u përkthyer në gjuhën angleze për tu botuar më vonë në një libër.

■ Më 15,16 prill 2010 Jehona Shala, koordinatorë e projektit, pati rastin ta prezantojë Projektin në konferencën “Parental Involvement in School Life Matters” të mbajtur në Beqiq, Mal të Zi.

Access Microscholarship Program

■ Orët e Access janë mbajtur me rregull. Janë duke u bërë përgatitje për përfundimin e kursit me një aktivitet social dy ditor, ku do të marrin pjesë edhe nxënësit e grupit Access nga Prizreni.

Koncepti i qytetarisë të nxënësit e shkollës fillore në Kosovë

■ Gjatë muajit prill, ekipi nga KEC dhe UP, ka punuar në përgatitjen e një raporti të hulumtimit të shpejtë, me qëllim të publikimit të tij. Pritet që ky raport të publikohet deri në fund të muajit qershor.

Projekti i përbashkët i historisë së Evropës Juglindore (JHP)

■ Në kuadër të këtij projekti, gjatë muajit prill, janë zhvilluar trajnimet në Pejë dhe Gjilan.

Me datat 17-18 prill, u mbajt trajnimi në Peje. Ky trajnim u zhvillua me praninë e rreth 26 mësime të lëndës së historisë nga Komuna e Pejës. Në grup kishte edhe disa mësime të komunitetit boshnjak. Trajnimi shkoi shumë mirë, të gjithë të pranishmit u ndanë të kënaqur me përmbajtjen dhe me materialet. Duhet përmendur që bashkëpunimi në mes të mësimeve gjatë punës në grupe ishte në nivel shumë të lartë.



■ Gjithashtu, një trajnim i ngjashëm u mbajt edhe në Gjiçan me datat 24-25 prill. Të pranishëm ishin mësime të lëndës së historisë nga komuna e Gjiçanit. Në grup kishte edhe mësime të komunitetit turk. Bashkëpunimi në grup ishte shumë i mirë, dhe të pranishmit u ndanë të kënaqur me përmbajtjen e trajnimit dhe me materialet e trajnimit.

Përgatiti: Petrit Tahiri